

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8254
E martë, 3 mars 2026
Çmimi 0.50 €

Mbrojtja e Thaçit në
Hagë: Dëshmitarët e kanë
bërë vetë publike ftesën
për dëshmi | FQA 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MUNGON VULLNETI PËR KONSENSUS PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI I DUHET SOT KOSOVËS?



Kanë mbetur edhe dy ditë deri në zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, ndërsa partitë politike ende nuk kanë arritur konsensus pavarësisht prej dy raundeve të takimeve të zhvilluara nga kryeministri Albin Kurti me

liderin e PDK-së, Bedri Hamza, dhe atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku. Ky i fundit në takim qe pati të hënën me Kurtin tha se e sheh shumë të vështirë çështjen e konsensusit politik në këtë kohë brenda partive shqiptare

**PELESHI:
SHQIPËRIA
MBETET ZËRI MË
I FUQISHËM NË
MBËSHTETJE
TË KOSOVËS
NË ARENËN
NDËRKOMBËTARE** F. 6



**RRITET ÇMIMI
I DERIVATEVE
NË KOSOVË PAS
SITUATËS NË
LINDJEN E MESME** F. 8

**FKEE DHE GERMAN ECONOMIC
TEAM DISKUTOJNË PËR ULJEN
E KONSUMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE** F. 8

SPORT



**SHKRUHET HISTORIA: PILOTJA E
KOSOVËS RENDITET E PARA NË BOTË
NË PARAGLLAJD** F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbz: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja ME ALEATË SHKËMBEJNË QINDRA SULME ME IRANIN

Organizata iraniane Gjysmëhëna e Kuqe njoftoi të hënën se 555 persona janë vrarë në sulmet e përbashkëta të ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit. Sipas raportit të saj, 131 qytete janë përfshirë nga sulmet që nga dita e parë e tyre më 28 shkurt

TEHERAN, 2 MARS - Me një deklaratë të përbashkët, Shtetet e Bashkuara, Bahrejni, Jordania, Kuvajti, Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe dënuan fuqishëm "sulmet e papërgjegjshme me raketa dhe dronë të Iranit ndaj territoreve sovraane në rajon". "Këto sulme pa bazë shënjestruan territore sovraane, rrezikuan popullsinë civile dhe dëmtojnë infrastrukturën civile", thuhet në deklaratë.

Edhe Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit, i udhëhequr nga Arabia Saudite, dënoi Teheranin për sulmet ndaj shteteve anëtare dhe theksoi "të drejtën për të reaguar" ndaj këtyre veprimeve. Ky këshill përfshin: Arabinë Saudite, Katarin, Omanin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejnin dhe Kuvajtin.

Deklarata e përbashkët e Uashingtonit dhe aleatëve të tij arabë thekson se veprimet e Iranit "paraqesin një përshkallëzim të rrezikshëm, që shkel sovranitetin e shteteve të shumta dhe kërcënon stabilitetin rajonal. Shënjestrimi i civilëve dhe vendeve që nuk janë të përfshira në konflikte është sjellje e papërgjegjshme dhe destabilizuese".

Izraeli njoftoi mëngjesin e së hënës se ushtria e tij ka goditur objektiva të lëvizjes Hezbollah në Liban, pasi ky grup militant - i mbështetur nga Irani - mori përgjegjësinë për një sulm me raketa dhe dronë në veri të Izraelit.

Izraeli tha se, "në përgjigje të sulmeve me predha nga Hezbollahu ndaj shtetit izraelit", forcat e tij "kanë filluar të godasin objektiva të organizatës terroriste Hezbollah në të gjithë Libanin".

Detajet mbeten të pakta, por dëshmitarët raportuan se dëgjuan shpërthime në periferitë jugore të Bejrutit - bastion i Hezbollahut.

Një ditë më herët Hezbollahu - grup militant shiit që prej kohësh konsiderohet aleat i Iranit - shprehu solidaritet me Teheranin pas sulmeve ajrore të ShBA-së dhe Izraelit, por la të kuptohej se nuk do të përfshihej drejtpërdrejt në konflikt.

Por, në një deklaratë Hezbollahu përmendi vrasjen e liderit suprem iranian, Ajatollah Ali Khamenei, si një nga arsytet për vendimin e tij për të nisur një sulm të ri.

Grupi tha se ka nisur "një breshëri raketash dhe një valë

dronësh... në hakmarrje për gjakun e pastër të Ajatollah Imam Sayyid Ali Al-Husseini Khameneit... dhe në mbrojtje të Libanit dhe popullit të tij".

Shpërthime dhe sirena alarmi në disa qytete të Lindjes së Mesme

Një valë e re sulmesh me raketa dhe dronë nga Irani u raportua gjatë orëve të fundit në disa qytete të Lindjes së Mesme.

Sipas raportimeve të agjencive Reuters dhe AFP, kryeqytetet Doha dhe Manama - respektivisht në Katar dhe Bahrej - si dhe Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Erbili në Rajonin Kurd të Irakut, ishin caqe të sulmeve të reja ajrore.

Banorët raportuan shpërthime të fuqishme dhe sirena alarmi. Nuk është ende qartë nëse shpërthimet janë shkakuar nga goditjet direkte të raketave dhe dronëve, apo nga ndërhyrja e sistemeve të mbrojtjes ajrore që i kanë goditur dhe shkatërruar ato.

Në Izrael, sirenat e alarmit ajror u aktivizuan në disa zona, përfshirë Tel Avivin dhe Jerusalemin.

Aktivizimi i sistemeve të mbrojtjes në Jerusalem u shoqërua me disa shpërthime.

Dhjetëra të vrarë nga sulmet izraelite në Liban

Sulmet izraelite në Bejrut dhe në Libanin jugor lanë të vrarë 31 persona dhe të plagosur 149 të tjerë, njoftoi Ministria e Shëndetësisë e Libanit.

Izraeli njoftoi mëngjesin e së hënës se ushtria e tij ka goditur objektiva të lëvizjes Hezbollah



në Liban, pasi ky grup militant - i mbështetur nga Irani - mori përgjegjësinë për një sulm me raketa dhe dronë në veri të Izraelit.

Detajet mbeten të pakta, por dëshmitarët raportuan se dëgjuan shpërthime në periferitë jugore të Bejrutit - bastion i Hezbollahut.

Disa avionë ushtarakë amerikanë rrëzohen në Kuvajt, ekuipazhet shpëtojnë

Një zëdhënës i Ministrisë së Mbrojtjes së Kuvajtit njoftoi se disa avionë ushtarakë amerikanë u rrëzuan mëngjesin e së hënës në territorin e këtij vendi, por se pilotët dhe ekuipazhet shpëtuan.

Autoritetet nisën menjëherë operacionet e kërkim-shpëtimit, ndërsa ekuipazhet u evakuuan dhe u dërguan në spital për kontrolle shëndetësore dhe trajtim të nevojshëm.

Zëdhënësi shtoi se ka pasur koordinim të drejtpërdrejtë me forcat amerikane për detajet e incidentit dhe se janë marrë disa masa të përbashkëta teknike.

Sipas tij, autoritetet po vazhdojnë të hetojnë, për të përcaktuar shkakun e rrëzimit.

Deri tani, Komanda Qendrore e Shteteve të Bashkuara -

Centcom nuk ka reaguar për këtë incident.

Larjani thotë se nuk do të negociojë me ShBA-në

Kryetari i Këshillit Suprem të Sigurisë Kombëtare të Iranit, Ali Larjani, tha se Teherani "nuk do të negociojë" me Uashingtonin. Ai i bëri komentet disa orë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, u zotua se do të vazhdojë t'i ndëshkojë "terroristët" me "forcën e plotë" të ushtrisë amerikane.

Në një postim në rrjetin X, Larjani shkroi: "Ne nuk do të negociojmë me Shtetet e Bashkuara. Sot kombi iranian po mbron veten".

Të dielën, në një video gjashtëminutëshe që postoi në platformën e tij "Truth Social", Trump tha se lufta kundër Iranit mund të zgjasë katër javë, megjithëse u duk se e la derën hapur për bisedime të mëtejshme me udhëheqësit mbijetues në Teheran. "Në 36 orët e fundit, Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e tyre po kryejnë Operacionin Tërbimi Epik - një nga ofensivat ushtarake më të mëdha, më komplekse dhe më dërrmuese që bota ka parë ndonjëherë", tha Trump. Ai shtoi se operacionet luftarake në Iran "po vazhdojnë me forcë të plotë" dhe "do të vazhdojnë derisa të arrihen të gjitha objektivat tona".

Gjysmëhëna e Kuqe: Më shumë se 550 persona të vrarë në Iran

Organizata iraniane Gjysmëhëna e Kuqe njoftoi të hënën se 555 persona janë vrarë në sulmet e përbashkëta të ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit. Sipas raportit të saj, 131 qytete janë përfshirë nga sulmet që nga dita e parë e tyre më 28 shkurt.

Gjysmëhëna e Kuqe shtoi se operacionet e shpëtimit, ndihmës, transportit dhe shërbimeve mjekësore janë

duke vazhduar.

Fotografite e publikuara më 1 mars, tregojnë dëme të konsiderueshme në bazat e raketave, radarët dhe objektet për avionë në Iran, pas një vale sulmesh ajrore të koordinuara nga ShBA-ja dhe Izraeli. Disa fotografi tregojnë edhe kompleksin në Teheran të liderit suprem iranian, Ajatollah Ali Khamenei, i cili u vra në një sulm më 28 shkurt.

Presidenti i Iranit, Masud Pezeshkian, ka emëruar gjeneralin e Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), Majid Ebnolreza, ministër të përkohshëm të Mbrojtjes.

Më herët, ai shërbente si zëvendësministër kryesor i Aziz Nasirzadehut, i cili u vra në një sulm izraelit, më 28 shkurt. "Me urdhër të presidentit Pezeshkian, gjenerali i brigadës, Seyyed Majid Ebnolreza, është emëruar ministër i përkohshëm i Mbrojtjes", shkroi Mohammad Mehdi Tabatabaei, nga zyra për komunikim e Pezeshkianit, në rrjetet sociale.

Çmimet e gazit në Evropë rriten mbi 25 %

Çmimet e gazit në tregjet holandeze dhe britanike u rritën për më shumë se 25 % të hënën në mëngjes. Rritja pasoi pas sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit dhe sulmeve të Republikës Islamike ndaj një numri vendesh në Lindjen e Mesme.

Po ashtu, shumë dërgesa naftë dhe gazi përmes Ngushticës së Hormuzit u pezulluan.

Agjencia e lajmeve Reuters, duke cituar burimet tregtare, raporton se pas paralajmërimit të qeverisë iraniane që anijet të mos kalojnë nëpër Ngushticën e Hormuzit, shumica e pronarëve të cisternave dhe kompanive të mëdha të energjisë kanë ndaluar transportin e naftës, karburanteve dhe gazit të lëngshëm natyror përmes kësaj rruge ujore.

Vitet e fundit, pas pushtimit ushtarak të Ukrainës nga Rusia, Evropa ka rritur importet e gazit të lëngshëm natyror, për ta zëvendësuar gradualisht gazin rus.

Rreth 20 për qind e gazit të lëngshëm natyror në botë kalon nëpër Ngushticën e Hormuzit.

Ndërprerja e zgjatur ose mbyllja e plotë e kësaj rruge do ta rriste konkurrencën globale për burime të tjera të gazit dhe do t'i rriste çmimet në nivel ndërkombëtar.



MUNGON VULLNETI PËR KONSENSUS PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI

Kanë mbetur edhe dy ditë deri në zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, ndërsa partitë politike ende nuk kanë arritur konsensus pavarësisht prej dy raundeve të takimeve të zhvilluara nga kryeministri Albin Kurti me liderin e PDK-së, Bedri Hamza, dhe atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku. Ky i fundit në takimin që pati të hënën me Kurtin tha se e sheh shumë të vështirë çështjen e konsensusit politik në këtë kohë brenda partive shqiptare



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 MARS - Kryeministri Albin Kurti, njëherësh edhe kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, ka taktuar të hënën për herë të dytë kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, në lidhje me zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. As në këtë takim nuk ka pasur konsensus për një gjë të tillë.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë pas takimit se aktualisht është e vështirë të arrihet konsensus politik për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. "E shoh shumë të vështirë çështjen e konsensusit politik në këtë kohë brenda partive shqiptare. Nuk ka ndonjë kandidat specifik në këtë fazë që na është prezantuar. Nuk na është kërkuar vota për ndonjë emër specifik. LDK-ja me 15 deputetë nuk mund të caktojë emër", u shpreh ai.

I pyetur për qëndrimin e LDK-së lidhur me emrin e Vjosa Osmanit për presidente, Abdixhiku tha se subjekti që ai drejton nuk ka marrë qëndrim për emra të përveçëm. "Ne nuk kemi qëndrim për emra të përveçëm, por s'kemi thënë asnjëherë që kemi apo s'kemi

votë për Osmanin. Unë prisja që ne partitë politike të diskutonim për emra. S'kishte emra, s'kishte propozime, s'kishte as vullnet për konsensus", ka deklaruar Abdixhiku.

Krejt në fund tha se për garë nuk beson që ka zgjidhje pasi, sipas tij, nëse PDK-ja dhe LV-ja vendosin për garë, atëherë do të shkohet në zgjedhje.

Takimi u zhvillua në një moment kur partitë politike ende nuk kanë arritur konsensus për një figurë unifikuese, ndërsa kreu i qeverisë e ka lënë të hapur mundësinë që, në mungesë të marrëveshjes, secila parti ta kandidojë emrin e vet në Kuvend.

Para takimit Kurti s'pranoi të diskutojë për emrat e përmendur për postin e presidentit, duke thënë vetëm se "duhet dikush që i siguron 80 vota".

Kurti ka deklaruar të dielën se beson që Murat Jashari, djali i Rifat Jasharit dhe pjesëtar i familjes së Adem Jasharit, do të ishte figurë e përshtatshme për pozitën e presidentit, duke theksuar se vendit, sipas tij, i duhet një personalitet që "u bënë ballë shtrëngatave" në rrethanat aktuale gjeopolitike. Megjithatë, Murat Jashari ka bërë me dije se nuk ka ambicie

për këtë pozitë.

Ndërkaq kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, në takimin që ka pasur të shtunën me kryeministrin Albin Kurti, ka thënë se i kanë bërë ofertë që presidenti të jetë i propozuar nga PDK-ja.

Presidentja aktuale, Vjosa Osmani, ka shprehur dëshirën për një mandat të dytë, por Lëvizja Vetëvendosje, që e kishte propozuar në mandatin e parë, nuk e ka përmendur emrin e saj si kandidat. Partitë opozitare e kanë kritikuar Osmanin për, siç kanë thënë, njëanshmëri në favor të qeverisë.

Çështja e presidentit, Cakolli: Gara po zhvillohet se kujt do t'i mbetet faji nëse vendi shkon sërish në zgjedhje

Eugen Cakolli nga KDI ka theksuar se "gara" po zhvillohet rreth asaj se kujt do t'i mbetet faji nëse vendi shkon sërish në zgjedhje, në vend që angazhimi të përqendrohet në arritjen e një zgjidhje që i jep vendit stabilitet. "Madje, kanë filluar të përmenden ide që krizat politike, të prodhuara artificialisht, t'i delegohen Gjykatës Kushtetuese, sikur ajo

të ishte mekanizëm për zgjidhje politike. Në fakt, vet mënyra si Kushtetuta e ka ndërtuar zgjedhjen e presidentit tregon se ky proces është menduar përtej votimeve të zakonshme të shumicës parlamentare. Kërkesa për kuorumin dhe votat e dy të tretave të deputetëve në raundet e para është një mekanizëm i qartë 'anti-shumicë', i projektuar për të prodhuar një president me mbështetje më të gjerë sesa shumica qeverisëse e momentit", ka shkruar Cakolli në "Facebook".

Ai ka thënë se procedura me së paku dy kandidatë dhe kërkesa për 30 nënshkrime për nominim e strukturon garën në mënyrë që të jetë nominalisht demokratike, ndërsa mbështetja politike të ndërtohet para votimit, me raundin e tretë që siguron përfundimin e procesit dhe vazhdimësinë institucionale. "Ky rregull procedural synon të garantojë që presidenca nuk kthehet në një vazhdim të përplasjes së zakonshme politike. Kalimi i afatit kushtetues për zgjedhjen e Presidentit - që është 5 e jo 4 marsi - e çon vendin në situatë të mospërbushjes së një obligimi kushtetues. Një gjendje

e tillë praktikisht mund të adresohet vetëm përmes zgjedhjeve të reja të parakohshme. Sepse, nëse afatet varen nga vullneti për të nisur procedurat, atëherë ato humbin çdo kuptim. Kjo, sa për analogji, do të ishte njësoj sikur afati për konstituimin e Kuvendit të mos fillonte pa u thirrur mbledhja konstituive", është shprehur ai.

Ai ka theksuar se, mbi të gjitha, normat kushtetuese nuk mund të lexohen të izoluara dhe vetëm në mënyrë literale, sepse asnjë kushtetutë nuk mund të parashohë çdo situatë politike. "Aq më pak që dështimi eventual i këtij procesi nuk do të jetë rezultat i ndonjë paqartësie kushtetuese, por i vullnetit politik. Apo, më saktë, i mungesës së tij për të gjetur zgjidhje", ka deklaruar ai.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, për të propozuar një kandidat për president nevojiten të paktën 30 nënshkrime deputetësh. Lëvizja Vetëvendosje i ka 57 deputetë, ndërsa asnjë parti tjetër nuk i ka e vetme 30 vota. Për zgjedhjen e presidentit kërkohen të paktën 80 vota në njërin nga dy raundet e para të votimit, ose 61 vota në raundin e tretë, nga gjithsej 120 deputetë sa ka Kuvendi.



KOSOVA PËRBALLË NJË TESTI TË MUNDSHËM TË SIGURISË

Raportimet për një rishikim të pranisë ushtarake amerikane në Evropë, duke përfshirë Kosovën, po shtohen. Pentagoni nuk e konfirmon dhe as mohon ndonjë plan të mundshëm, duke lënë të hapur pyetjen për stabilitetin në KFOR. Ekspertët theksojnë se roli amerikan në Kosovë shkon përtej aspektit ushtarak, duke përfshirë edhe një funksion të rëndësishëm politik dhe parandalues

Prishtinë, 2 mars - Në qershor të vitit 1999, në kohën kur Kosova po dilte nga lufta dhe refugjatët po ktheheshin, NATO-ja vendosi misionin e saj paqeruajtës, KFOR, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt dhe parandalimin e rikthimit të dhunës. Ai nuk ishte misioni i parë i aleancës ushtarake, por do të bëhej misioni i saj më jetëgjatë, operacioni më i madh aktiv dhe një nga ndërhyrjet më të suksesshme.

Forca shumëkombëshe numëronte fillimisht mbi 50 000 ushtarë, prej të cilëve rreth 7 000 amerikanë. Sfidat për ndërtimin e një të ardhmeje pas shkatërrimit të gjerë që la sulmi serb, ishin të jashtëzakonshme, sipas presidentit të atëhershëm amerikan, Bill Clinton.

Pesë muaj pas përfundimit të luftës ai udhëtoi në Kosovë për t'i takuar trupat amerikane në kampin Bondsteel - bazën më të

madhe ushtarake të ShBA-së në Ballkan dhe një nga simbolet më të fuqishme të pranisë së saj në rajon. "E di se shumë nga detyrat tuaja janë ende të rrezikshme. E vlerësoj punën e palodhshme që keni bërë për t'i mbrojtur të gjithë njerëzit në Kosovë, përfshirë edhe serbët. Dhe, e vlerësoj ndërmjetësimin tuaj të vazhdueshëm mes njerëzve që kanë ende një rrugë të gjatë drejt pajtimit", pati thënë Clintoni në nëntor të vitit 1999.

Më shumë se 26 vjet më vonë siguria në Kosovë është përmirësuar ndjeshëm, ndërsa prania e KFOR-it është zvogëluar në rreth 4 700 trupa. Megjithatë, reduktimi i forcave nuk do të thotë se stabiliteti është i garantuar.

Mungesa e pajtimit të plotë dhe refuzimi i vazhdueshëm i Serbisë për ta njohur pavarësinë e Kosovës, e mbajnë hapur dimensionin e sigurisë. Në këtë

kontekst, çdo sinjal për një rol më të vogël të Shteteve të Bashkuara në KFOR merr peshë të veçantë.

Ndryshimet në prioritetet globale të sigurisë kanë nxitur diskutime - jo gjithmonë zyrtare - për mundësinë e një reduktimi të angazhimit amerikan në KFOR, duke hapur pyetje edhe për të ardhmen e arkitekturës së sigurisë në Kosovë.

Në një përgjigje që mori Radio Evropa e Lirë prej Pentagonit më 19 shkurt u tha se nuk ka ndonjë njoftim për ndryshim të dislokimit të forcave. Por, po atë ditë, gazeta amerikane "Politico", duke cituar katër diplomatë të NATO-s, raportoi se Shtetet e Bashkuara po kërkojnë nga aleatët ta shqyrtojnë reduktimin e angazhimeve të jashtme të aleancës, përfshirë edhe misionin në Kosovë.

Kjo nuk është hera e parë që ngrihen pikëpyetje për të

ardhmen e trupave amerikane në Evropë.

Në shkurt të vitit të kaluar, sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, paralajmëroi se kontinenti duhet të përgatitet për një rishikim dhe reduktim eventual të pranisë ushtarake amerikane, duke theksuar se vendimet do të varen nga kërcënimet globale dhe prioritetet strategjike të Uashingtonit.

Po atëkohë, zëvendës-presidenti amerikan JD Vance e lidhi të ardhmen e trupave në Evropë me politikëbërjen në rajon, duke deklaruar se amerikanët nuk do ta mbështesin mbajtjen e trupave në Gjermani nëse qytetarët atje përballen me ndëshkime për postime fyese në rrjetet sociale.

Radio Evropa e Lirë pyeti NATO-n nëse vendet evropiane kanë kapacitet ta mbushin boshllëkun që mund të krijohet nga një tërheqje ose reduktim i mundshëm i forcave amerikane në KFOR, të cilat aktualisht numërojnë rreth 590 ushtarë.

Në përgjigjen e marrë nga një zyrtar nuk jepen detaje konkrete, por theksohet se "Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të luajnë një rol themelor në sigurimin e stabilitetit afatgjatë

të Kosovës dhe të rajonit, përmes misionit të KFOR-it, të udhëhequr nga NATO-ja".

Radio Evropa e Lirë u dërgoi pyetje edhe ministrive të Mbrojtjes në Itali, Hungari dhe Turqi - tri nga vendet me kontributin më të madh në KFOR - për gatishmërinë e tyre për të ofruar forca dhe mjete shtesë - por asnjëri nga institucionet nuk u përgjigj.

Igor Tabak, analist ushtarak në portalin "Mbrojtja dhe Siguria" në Zagreb, thotë se Evropa ka kapacitetin për të mbuluar boshllëkun që mund të lërë një rol më i vogël i ShBA-së në KFOR. Ai shpjegon se vendet evropiane kanë rritur investimet në mbrojtje gjatë viteve të fundit, duke përfshirë jo vetëm blerjen e teknologjisë së re, por edhe aftësimin e personelit. "Natyrisht, ShBA-ja është aleatja më e madhe në NATO, por nuk është e vetmja. Ka disa resurse që i posedon vetëm ajo, ndërsa vendet e tjera jo. Shumica prej tyre, siç e ka treguar edhe lufta në Ukrainë, lidhen me armët bërthamore dhe mbrojtjen raketore. Por, këto nuk janë kapacitete që i nevojiten KFOR-it, prandaj prania amerikane mund të zëvendësohet", thotë Tabak për programin Expose të

KURTI MBLODHI KËSHILLIN E SIGURISË PAS ZHVILLIMEVE NË LINDJE TË MESME: QËNDROJMË PËRKRAH SHBA-së

PRISHTINË, 2 MARS - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të shtunën vonë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurisë për të diskutuar rreth zhvillimeve të fundit të situatës së sigurisë në Lindjen e Mesme. Mbledhja është mbajtur me kërkesë të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. "Kryeministri Kurti ka ritheksuar qëndrimin e qartë të institucioneve të Republikës së Kosovës se qëndrojnë të palëkundura përkrah miqve dhe aleatëve tanë strategjikë, në veçanti të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, në përpjekjet për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar", është thënë në një komunikatë të Kryeministrit. Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli kanë nisur të shtunën sulme kundër Iranit, të cilat kanë rezultuar me vrasjen e liderit suprem Ajatollah Ali Khamenei dhe dhjetëra figurave të tjera të larta shtetërore. ShBA-ja bëri me dije se sulmet i nisi pasi e kuptoi se Irani nuk kishte gatishmëri të bënte kufizime të theksuara në programin bërthamor dhe atë

të raketave. Është politikë e kamotshme e ShBA-së që Irani nuk mund të ketë kurrë armë bërthamore. Irani është kundërpërgjigjur në ditën e nisjes së sulmeve, duke synuar bazat ushtarake amerikane në vendet e rajonit, por duket se raketat dhe dronët e tij janë rrëzuar. Në komunikatën e Kryeministrit është përmendur se Kosova solidarizohet me popullin e Iranit dhe aspiratat e tij legjitime për liri, dinjitet dhe të drejta themelore. "Institucionet e Republikës së

Kosovës tashmë kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në Republikën e Kosovës, dhe se janë duke i monitoruar për së afërmi zhvillimet në Lindjen e Mesme, sikurse edhe implikimet e mundshme për Kosovën dhe rajonin. Ne, po ashtu, jemi në komunikim të afërt dhe të vazhdueshëm edhe me partnerët tanë strategjikë". Izraeli tha të dielën se po i vazhdon sulmet kundër shënjestrave të regjimit "në zemër të Teheranit", teksa Irani po kryen sulme në shtetet e

Gjirit Arab. Për sulme është raportuar në Dubai të Emirateve, në Doha të Katarit, në Bahrein dhe Kuvajt. Presidenti amerikan Donald Trump e quajti Khamenein "një prej njerëzve më djallëzor në histori" dhe u bëri thirrje iranianëve ta marrin në duar shtetin e tyre. Irani u zotua për "ofensivë shkatërruese" kundër bazave amerikane dhe Izraelit në shenjë hakmarrjeje. Trumpi i tha që të mos veprojnë ashtu sepse do të përballet me forcën më të madhe të parë ndonjëherë.



Radios Evropa e Lirë.

Ish-ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Fatmir Mediu, i cili aktualisht udhëheq Qendrën e Sigurisë së Evropës Juglindore, pajtohet se vendet evropiane kanë kapacitet për të marrë një rol më të madh ushtarak në Kosovë, por shton se prania amerikane ka rëndësi që shkon përtej këtij aspekti. "Nga pikëpamja politike, prezenca e trupave amerikane në Kosovë është shumë e rëndësishme. Ndaj, diplomacia e Kosovës duhet të jetë shumë më e shkathët. Nuk është vetëm çështje sigurie, por edhe e partneritetit afatgjatë, që lidhet edhe me qëllimin e Kosovës për anëtarësim në NATO. Si e tillë, situata do të krijonte një lloj hendikapi", thotë Mediu për Exposed.

Kosova, përveç Serbisë, ka në fqinjësi tri vende anëtare të NATO-s: Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Ndryshe nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, ajo nuk është as pjesë e Partneritetit për Paqe - programit të NATO-s për bashkëpunim me vendet partnere - për arsye politike. Forca e saj e Sigurisë është në proces të shndërrimit në ushtri me kapacitete të plota, dhe zyrtarët e saj thonë se kanë aftësinë për të mbrojtur vendin

Sa trupa i ka NATO-ja në Kosovë?

Gjithsej 4 686 trupa nga 29 vende të botës shërbejnë aktualisht në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), KFOR. Më shumë se gjysma e forcave janë nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungaria dhe Turqia. NATO-ja e ka shtuar praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

dhe integritetin e tij territorial. Megjithatë, FSK-ja, ende sot, nuk mund të operojë në veri të Kosovës, ku popullsia shumicë është serbe, pa lejen e KFOR-it. Ky mision është përgjegjës për sigurinë e kufirit tokësor të Kosovës me Serbinë, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare, përgjegjëse është Policia e Kosovës. Tabak nuk beson se tërheqja eventuale e ShBA-së nga KFOR-i do ta ndryshonte ndjesinë e sigurisë në Kosovë. "Nuk është rastësi që, muajt e fundit, janë shfaqur iniciativa për bashkëpunim në mbrojtje midis Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës. Të tria vendet kanë arritur marrëveshje konkrete në këtë drejtim. Kjo tregon se po punohet për t'u siguruar që stabiliteti në rajon, të mos varet ekskluzivisht nga vullneti i Uashingtonit, i cili mund të ndryshojë me kalimin e kohës", thotë Tabak. Por, Mediu nuk e ndan këtë mendim. Sipas tij, prania

amerikane ka një efekt të fortë parandalues në Kosovë, duke ndikuar drejtpërdrejt në kalkulimet e Serbisë dhe aktorëve të tjerë. Nëse kjo prani dobësohet, mund të inkurajohen provokime ose përshkallëzime të reja, paralajmëron ai. "Unë mendoj se çdo problem ose perceptim negativ mbi marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara, mund të nxisë qëndrime dhe provokime kundër Kosovës, të cilat mund të përshkallëzohen, duke pasur parasysh edhe interesin e Ruisë për të krijuar një pikë tjetër konflikti dhe për të zhvendosur vëmendjen nga ajo që po ndodh në Ukrainë", shton Mediu. Sipas tij, zgjidhja qëndron te diplomacia e zgjuar dhe pragmatike e Kosovës. Ai rekomandon që vendi të orientohet nga interesat amerikane, duke treguar se është partner i besueshëm dhe jo burim problemesh. "Ne jemi vende periferike në politikën e

sigurisë së ShBA-së. Për t'u bërë të rëndësishëm, duhet të sillemi jo si njerëz që krijojmë probleme, por që japim zgjidhje. Analizën duhet ta nisim nga interesi amerikan dhe pastaj të kalojmë tek interesat tona. Të mos themi se kemi probleme me Serbinë, por se problemet në rajon, për shkak të Serbisë, Ruisë, Kinës, bien ndesh me Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare, që ka miratuar Trump, dhe më pas të lëvizim tek interesat tona të brendshme", thotë Mediu. Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes në Kosovë ka shënuar rritje të ndjeshme vitet e fundit, duke kaluar nga 67.3 milionë euro në vitin 2021 në mbi 216 milionë euro këtë vit. Por, të dy ekspertët vërejnë se ky buxhet mbetet i kufizuar, përballë kostove të larta të armëve dhe pajisjeve moderne. Sipas tyre, Kosova mund t'i përforcojë këto kapacitete duke bashkuar buxhetet me vendet anëtare të NATO-s në Ballkan, duke krijuar

nivele operative të përbashkëta dhe duke nxitur investime strategjike nga industria ushtarake amerikane. Sepse, në fund të fundit, ekonomia ndikon dhe vendos për shumë gjëra, thotë Mediu. Akti i Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare, që përmend ai, synon të forcojë angazhimin ushtarak të ShBA-së në Evropë, garanton 76.000 trupa amerikane në kontinent dhe ndalon tërheqjen e mëdha të pajisjeve. Megjithatë, ai bie ndesh me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, e cila thekson se "çështjet e vendeve të tjera janë shqetësim i ShBA-së vetëm nëse aktivitetet e tyre kërcënojnë interesat amerikane". Javën e kaluar, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në takim me të ngarkuarën me punë të ShBA-së në Prishtinë, Anu Prattipati, theksoi rëndësinë e pranisë ushtarake amerikane dhe të aleatëve në kuadër të NATO-s si faktor kyç për stabilitetin. Ndërsa, ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, takoi ambasadorin amerikan në NATO, Matthew Whitaker. Tani, nëse Amerika një ditë bën një hap pas, Evropa mund të përballet me provën më të madhe të rolit të saj si garantuese e sigurisë në kontinent.

DONALD TRUMPI DHE DORA HYJNORE!

Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

I.
E shtunë, 14 korrik 2024. Në vllugun e fushatës zgjedhore presidenciale, në mitingun e mbajtur në Butler të Pensilvanisë, u bë përpjekje për të vlarë Donald Trumpin. Dorasi kishte shënjuar kokën e ish presidentit Trump, por si nga një dorë hyjnore, trajektorja e plumbit ndryshoi kahe dhe i shkaktoi një plagë të lehtë në vesh.
Për besimtarët e religjioneve abrahamike nuk kishte asnjë dyshim: ndodhi një Mrekulli hyjnore!

II.
I ndodhur në një kontekst gjeopolitik me konflikte të shumta, misioni i presidentit Trump për ngadhënjimin e paqes në botë ndeshet edhe me verbërimin ideologjik të atyre që publikisht kërkonin "Vdekjen e Amerikës" dhe "vdekjen e izraelit".
Prandaj doli si prioritet shmangia e rreziqeve që kërcënonin sigurinë kombëtare të ShBA-së dhe të miqve të saj.



III.
Në qershor të vitit 2025 ShBA-të dhe Izraeli sulmuan Iranin. Gjatë 12 ditëve të bombardimeve, u përpoqën të shkatërronin kapacitetin e këtij shteti për të krijuar armët bërthamore dhe rrjedhimisht t'ia pamundësonin përpjekjet për t'u shndërruar në një fuqi që do të rrezikonte tërë regjionin.

Me shpresë se do të gjendej një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve, luftimet u ndërpreu pas 12 ditësh.
Ndërkohë në Iran shpërtheu një revoltë e paparë e popullit iranian kundër regjimit teokratik. Dhuna e pushtetit ishte e tmerrshme: me mijëra të vlarë dhe mbi 53 mijë të arrestuar. Përveç vrasjeve të

protestuesve në rrugë, gjatë proceseve "gjyqësore", 1922 të rinj dhe të reja u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan.

IV.
Përpjekjet që të gjendej një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve dështuan dhe luftimet filluan përsëri.
Nëse marrim Kuranin, librin e

shenjtë të besimit islam, edhe ajo që po ndodh në Iran, është e përcaktuar nga Zoti dhe se askush nuk mund ta pengojë.
Çdo njeri që ka njohuri për besimin islam e di shumë mirë se sipas këtij besimi "çdo gjë që do të ndodh në tokë dhe në gjithësi, nga Dita e Krijimit deri në Ditën e Gjykimit, është shkruar në Librin e Librave, në Leuhi Mahfudh.". Madje "Te Allahu janë çelësat e të gjitha fshehtësive dhe asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai..." (Kurani, Surja EL-EN'ÂM, ajeti 59) dhe se "Asnjë fatkeqësi nuk ndodh në tokë e as në shpirtrat tuaj, e që të mos jetë në Libër para se Ne ta krijojmë atë..." (Kuran, Sureja EL-HADID, ajeti 22)

Nga cilido këndvështrim fetar abrahamik që të shihet, Dora Hyjnore e shpëtoi Donald Trumpin nga vrasja për t'i mundësuar edhe popullit iranian të çlirohet nga pushteti teokratik.
Prandaj në Iran dëgjohen brohoritjet:
God bless America!
God bless Donald Trump!

POLICIA ARRESTON PESË SERBË TË DYSHUAR PËR VRASJET NË SYRIGANË GJATË LUFTËS

Prishtinë, 2 mars - Policia e Kosovës ka bërë me dije të dielën se i ka arrestuar pesë persona në Skenderaj, të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka bërë me dije se bëhet fjalë për arrestim të serbëve lokalë të Kosovës. Të dyshuarit besohet që i kanë vlarë gjashtë civilë shqiptarë në fshatin Syriganë të Skenderajt në periudhën maj - qershor 1998. Atyre u është caktuar një masë fillestare prej 48 orësh paraburgim.
Duke ofruar më shumë hollësi, policia ka thënë se e ka nisur operacionin e arrestimit në orët



e hershme të mëngjesit në gjashtë lokacione të ndara: pesë në komunën e Skenderajt dhe një në Mitrovicën e Veriut.

Sipas policisë, gjatë batisjeve në objektet e banimit dhe objektet përcjellëse janë konfiskuar: një armë e gjatë gjysmautomatike

SKS, një armë brezi e tipit Zastava M-57, dy karikatorë dhe 77 fishekë, një pushkë gjuetie me 17 fishekë dhe një rrethatore brezi, si dhe uniforma të ndryshme ushtarake dhe pjesë përbërëse të uniformave të ish-ushtresë jugosllave.
Lista Serbe ka reaguar ashpër ndaj aksionit policor, duke thënë se të dielën janë arrestuar "pesë nga bashkatdhetarët tanë, pronarë të ndershëm dhe të ndershëm shtëpish".
Kjo parti, e cila i ka nëntë ulëse në Kuvendin e Kosovës, e ka kritikuar atë që e ka quajtur "regjim" të kryeministrit të

Kosovës, Albin Kurti, që "pa prova të vlefshme arreston serbët, duke i paditur ata për krime lufte me qëllimin e qartë të frikësimit dhe persekutimit të tyre".
Gjatë luftës në Kosovë, nga viti 1998 deri në 1999, u vranë mbi 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën.
Më shumë se 1 500 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.
Qindra shqiptarë të vlarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi. Trupat e tyre janë bartur nga forcat serbe me qëllim që të fshihen krimet.

Peleshi: Shqipëria mbetet zëri më i fuqishëm në mbështetje të Kosovës në arenën ndërkombëtare

Prishtinë, 2 mars - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Niko Peleshi, ka realizuar të hënën një vizitë në Kosovë, ku është takuar me liderët shtetërorë, presidenten Vjosa Osmani, kryeparlamentaren Albulena Haxhiu dhe kryeministrin Albin Kurti. "Shqipëria mbetet zëri më i fuqishëm në mbështetje të Kosovës në arenën ndërkombëtare, për

ta avancuar integrimin euroatlantik, shtimin e njohjeve dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Koordinimi ynë është thelbësor për forcimin e stabilitetit dhe sigurinë e paqen në rajon", ka thënë ai pas këtyre takimeve.
Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se lidhja ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

është e natyrshme, strategjike dhe e pathyeshme. "Uniteti ynë është forcë, koordinimi ynë është garanci, ndërsa vizioni ynë është paqja, stabiliteti dhe e ardhmja e përbashkët euroatlantike. Në kohë sfidash globale, qëndrimi ynë i përbashkët janë forca dhe siguria jonë", ka thënë Osmani pas këtij takimi.



MBROJTJA E THAÇIT NË HAGË: DËSHMITARËT E KANË BËRË VETË PUBLIKE FTESËN PËR DËSHMI

HAGË, 2 MARS - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, mbrojtja e Hashim Thaçit nisi të hënën të marrë në pyetje dëshmitarin e parë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), në gjykimin ndaj Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për pengim të drejtësisë.

Dëshmitari, i cili kishte nisur dëshminë më 27 shkurt si i ftuari i parë i Prokurorisë në këtë rast, u mor në pyetje nga avokatja e Thaçit, Sophie Menegon.

Në gjykatore u bë me dije se ai është pjesë e stafit të Prokurorisë.

Seanca, që nisi në orën 9:30, herë pas here kaloi në pjesë të mbyllura për publikun.

Gjatë seancës Menegon u fokusua në procedurat që lidhen me dëshmitarët në rastin tjetër ndaj Thaçit për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, duke argumentuar se disa prej tyre e kanë bërë vetë publike faktin se janë ftuar për të dëshmuar.

Si shembull ajo përmendi Rrustem Mustafën, i njohur si Remi, për të cilin tha se kishte deklaruar vetë në medie se ishte ftuar për të dëshmuar në Hagë, raporton REL.

Dëshmitari i Prokurorisë tha se Remi nuk ishte vendosur nën masa mbrojtëse, pasi është figurë publike dhe ka folur më herët publikisht për këto çështje.

Në seancën e 27 shkurtit, i pyetur për procedurat, ai kishte



thënë se dëshmitarët zakonisht udhëtojnë për në Hagë 7 - 10 ditë para datës së dëshmisë, për t'u përgatitur duke analizuar deklaratat e mëhershme dhe materiale të tjera. Sipas tij, dëshmitarët kanë të drejtë të korrigjojnë ose ndryshojnë dëshminë e tyre.

Sipas aktakuzës, për disa muaj gjatë vitit 2023, të akuzuarit kanë ndërhyrë në çështjen gjyqësore ndaj Thaçit dhe tre ish-eporëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të akuzuar për krime lufte dhe

krime kundër njerëzimit.

Në seancën paraprake, Thaçi, Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi ta.

Në deklaratën hyrëse, Prokuroria ka thënë se Thaçi ka udhëhequr tri grupe në përpjekje për të ndikuar dëshmitarë të caktuar në rastin e parë kundër tij. Ajo ka deklaruar se ka dëshmi, përfshirë audioincizime të realizuara në qendrën e paraburgimit në Hagë, ku pretendohet se Thaçi udhëzon

të akuzuarit që të ndikojnë që dëshmitarë të caktuar, përfshirë edhe të mbrojtur, ta ndryshojnë dëshminë e tyre.

Prokuroria ka thënë se te disa nga të akuzuarit janë gjetur materiale që dyshohet se u janë dhënë nga Thaçi.

Thaçi, ish-president i Kosovës, akuzohet edhe për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, së bashku me tre ish-eporë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Të katërtit i kanë mohuar

akuzat.

Në këtë rast, nga java e kaluar janë duke u zhvilluar deklaratat përmbyllëse, gjatë të cilave mbrojtja argumentoi se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për krimet e pretenduara, ndërsa prokuroria kërkoi që të katërtit të shpallen fajtorë.

Pas përmbylljes së deklaratave, çështja do të kalojë te trupi gjyqësor, i cili ka afat tre muaj për të marrë një vendim ose mund ta kërkojë zgjatjen e këtij afati.

GJYKATA E STRASBURGUT REGJISTRON PËR HERË TË PARË PADINË KUNDËR SERBIË PËR PASIVIZIMIN E ADRESAVE NË LUGINË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 MARS - Gjykata e Strasburgut ka regjistruar për herë të parë padinë kundër Serbisë lidhur me pasivizimin e adresave të shqiptarëve që jetojnë në Luginë të Preshevës. Kështu ka bërë me dije avokati Drini Grazhdani, i cili ka thënë se padia është dorëzuar për shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur ndaj Teuta Fazliut. Ai ka thënë se kjo është një fitore fillestare, për çka u zotua se do të jetë i përkushtuar që të përfundojë me fitore të plotë. Gjykata e Strasburgut për herë të



parë ka regjistruar padinë të cilën e kam dorëzuar kundër Serbisë, lidhur me pasivizimin e adresave të shqiptarëve që jetojnë në Luginë të Preshevës,

Medvegjë dhe Bujanoc. "Padia është dorëzuar për shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur ndaj Teuta Fazliut. Serbia është angazhuar në

spastrim etnik administrativ ndaj shqiptarëve, duke i pasivizuar adresat jo vetëm të atyre që punojnë jashtë, por edhe të atyre që jetojnë brenda vendit. Ky pasivizim nuk është simbolik, i detyron shqiptarët të largohen, pasi qytetarët humbasin të drejtën për të marrë letërnjoftim/pasaportë të re, të drejtën e pensionit, sigurimin shëndetësor, të drejtën e votës, etj. Regjistrimi i padisë dhe pajisja me numër aplikimi nga Gjykata e Strasburgut është një hap procedural shumë i rëndësishëm, duke marrë parasysh se kjo gjykatë refuzon mbi 90 % të rasteve që në fazën

fillestare. Qëllimi im kryesor është që përmes këtij rasti, gjykata të zbatojë procedurën e vendimit pilot (rregulla 61). Kjo do të thotë që vendimi të mos mbetet vetëm për Teutën, por të detyrojë Serbinë të ndalojë këtë praktikë sistematike për të gjithë dhe të aplikohet në të gjitha rastet e ngjashme. Në të njëjtën kohë u bëj thirrje të gjithë të prekurve nga pasivizimi që t'i ndjekin procedurat e brendshme ligjore në Serbi, pa marrë parasysh faktin se Serbia i refuzon ato. Kjo është një fitore fillestare. Jam i përkushtuar të përfundojë me fitore të plotë", ka thënë Grazhdani.

Gjyqësorit të Kosovës i shtohen 21 bashkëpunëtorë profesionalë të rinj

PRISHTINË, 2 MARS - Gjyqësorit të Kosovës i janë bashkuar njëzet e një bashkëpunëtorë profesionalë të rinj, duke forcuar më tej kapacitetet e institucioneve gjyqësore në

vend. Prej tyre, katërmëdhjetë janë femra dhe shtatë meshkuj, ndërsa një i përket komuniteteve joshumicë. Bashkëpunëtorët profesionalë

janë shpërndarë në gjykatat dhe degët përkatëse, në përputhje me nevojat e sistemit gjyqësor. Angazhimi i tyre pritet të kontribuojë në rritjen e

efikasitetit, përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe forcimin e mëtejshëm të besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.



Rizvanolli në Toronto, takime me institucione dhe përfaqësues të sektorit minerar në Kanada

PRISHTINË, 2 MARS - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e shoqëruar nga ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, po merr pjesë në PDAC 2026 në Toronto, një nga konferencat më të mëdha dhe më të rëndësishme globale të eksplorimit mineral dhe industrisë minerare. Rizvanolli zhvilloi takime pune me partnerë institucionalë dhe

përfaqësues të industrisë kanadeze, me fokus në shkëmbimin e përvojave për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe krijimin e urave për bashkëpunime konkrete në të ardhmen. PDAC 2026 (Prospectors & Developers Association of Canada) mbledh mbi 27 000 pjesëmarrës nga mbi 125 shtete,

me program të gjerë profesional, rrjetëzim, si dhe ekspozitë të industrisë ku përfshihen mbi 1 300 ekspozues dhe qindra prezantues. Në këtë mandat, sektori minerar është përcaktuar si një ndër prioritetet zhvillimore dhe ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në funksion të këtij orientimi është paraparë një investim publik prej rreth 50 milionë eurosh në këtë sektor.



RRITET ÇMIMI I DERIVATEVE NË KOSOVË PAS SITUATËS NË LINDJEN E MESME

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 MARS - Kryetari i Shoqatës së Natarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se situata gjeopolitike në Lindjen e Mesme po ndikon drejtpërdrejt në tregjet e naftës. Si pasojë e kësaj, çmimet e naftës janë rritur edhe në Kosovë. Nafta është rritur nga 1 euro e 18 centë deri në 1 euro e 25 centë. Ai ka thënë se rritja e tensioneve dhe rreziku për ndërprerje në prodhim apo transport po shtojnë pasigurinë në furnizimin global, duke shtyrë çmimet e naftës më lart. “Vëmendja është veçanërisht te



Ngushtica e Hormuzit, një nga rrugët më të rëndësishme të kalimit të naftës në botë. Çdo problem në atë korridor reflektohet menjëherë në tregje dhe zakonisht përkthehet në kosto më të larta të karburantit për konsumatorët. Çmimet aktuale në Kosovë janë: Diesel 1.18 euro deri 1.25 euro. Benzin 1.17 euro deri 1.24 euro”, ka thënë Berjani.

AKB-ja: Blokimi i Ngushticës së Hormuzit nga ushtria iraniane rrezikon tregjet globale të naftës

Edhe kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka theksuar se po ndjek me shqetësim situatën kritike në Ngushticën e Hormuzit, ku forcat detare të Iranit kanë paralajmëruar se anijet nuk lejohet të kalojnë, duke bllokuar praktikisht trafikun e shumë tankerëve dhe cisternave të naftës. “Sipas raportimeve ndërkombëtare, qindra cisterna dhe tankerë

janë ndalur dhe kanë vështirësi për qarkullim ose po presin pranë rajonit, potencialisht mund të jenë të bllokuara qindra miliona deri në 1 miliard fuçi naftë. Ngushtica e Hormuzit transporton rreth 20% të furnizimit global me naftë. Kjo naftë kryesisht vjen nga vendet e Gjirit Persik si Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajti, Irani dhe Iraku, dhe destinacionet kryesore janë Evropa, Kina, India, Japonia dhe vendet e tjera të Azisë, duke e bërë çdo bllokim një kërcënim serioz për furnizimin global”, ka thënë Shahini. Ai ka theksuar se kjo situatë

mund të shkaktojë rritje të menjëhershme të çmimeve të derivateve, goditje për transportin dhe industrinë globale, por edhe ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ekonominë e Kosovës pasi, sipas tij, ne nuk posedojmë rezerva të mjaftueshme të derivateve. “AKB vlerëson se zhvillimet gjeopolitike dhe ushtarake po ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin ekonomik dhe kërkon nga institucionet që të jenë të përgatitura për çdo skenar në tregun e energjisë. Nafta është siguri ekonomike e një shteti”, tha Agim Shahini, kryetar i AKB-së.

ATK-ja: DEKLARIMET E SAKTA NDIHMOJNË NË PLANIFIKIMIN E KONTROLLEVE DHE FORCIMIN E SISTEMIT TATIMOR

PRISHTINË, 2 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës ka organizuar seminarin informues me temë “Deklarimi vjetor i tatimeve dhe raportimi i pasqyrave financiare”, ku u theksua rëndësia e raportimit të saktë dhe bashkëpunimit me profesionistët për forcimin e sistemit tatimor, raporton “Ekonomia Online”. Aty u theksua se përbushja e drejtë e obligimeve tatimore ndikon drejtpërdrejt në hartimin e politikave fiskale, planifikimin e kontrolleve dhe vendimmarrjen institucionale.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Mentor Hyseni, ka thënë se institucioni mbledh miliona deklarime gjatë vitit, të cilat shfrytëzohen jo vetëm nga ATK-ja, por edhe nga institucione të tjera shtetërore. Ai ka theksuar se raportimi i drejtë dhe i saktë është thelbësor për krijimin e politikave fiskale, planifikimin e kontrolleve dhe furnizimin me informata të sakta për institucione si prokuroria dhe policia, duke shtuar se vendimet më të mira merren mbi bazën e të dhënave të sakta. “ATK-ja mbledh miliona



deklarime gjatë vitit dhe këto deklarime shfrytëzohen dhe përdoren prej shumë institucioneve të tjera, jo vetëm prej ATK-së. Prandaj po dua të them se sa është i rëndësishëm raportimi i drejtë dhe i saktë vjetor që ju bëni si profesionistë

në ATK. Me një raportim të drejtë apo të saktë, jo vetëm që ne mund të krijojmë politika fiskale si shtet, por ne si administratë tatimore mund t'i planifikojmë kontrollet e ndryshme ose shqyrtimin e problematikave të ndryshme. Po ashtu, edhe institucionet e tjera siç janë Prokuroria e Shtetit, policia, pra të gjitha institucionet, mund të furnizohen me informata të drejta dhe të sakta, pastaj të marrin vendimet e duhura. Pra, vendimet e mirinformuara janë vendimet më të sakta për nga

natyra për shkak se ato bëhen në bazë të analizave të të dhënave të sakta që ju i dërgoni. Pra, kjo tregon rëndësinë e rolit tuaj si kontabilist, auditor ose si përfaqësues të tjerë të biznesit që jeni këtu”, ka thënë Hyseni. Ndërkaq kontabilistja dhe auditorja e certifikuar në ATK, Elvira Ibrahim Hoti, ka pohuar se përbushja tatimore rritet jo vetëm përmes deklaramit, por edhe përmes ndërtimit të besimit që, sipas saj, kontribuon në buxhetin e shtetit dhe më pas kthehet në të mirë të qytetarëve.

FKEE dhe German Economic Team diskutojnë për uljen e konsumit të energjisë elektrike

PRISHTINË, 2 MARS - Në zyrat e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të German Economic Team dhe drejtorit të Departamentit të Operacioneve të FKEE-së, Petrit Ahmeti, së bashku me udhëheqësit e sektorëve publikë dhe rezidencialë. Gjatë takimit u prezantua një pasqyrë e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë, duke përfshirë analizën mbi funksionimin dhe sfidat aktuale.

U diskutua edhe studimi mbi përmirësimin e Departamentit të Burimeve të Ripërtëritshme në Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) si dhe monitori ekonomik i përgatitur nga German Economic Team. Pjesë e rëndësishme e diskutimit ishte hulumtimi që trajtonte pjesëmarrjen e sektorit të banimit në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e FKEE-së theksuan interesin dhe rolin e

këtij fondi përmes projekteve të eficiencës së energjisë, të cilat synojnë uljen e konsumit në sektorin rezidencial përmes zbatimit të masave konkrete të EE-së. Të dyja palët ndanë ide dhe shprehën përkushtimin për bashkëpunim të mëtejshëm në hulumtime dhe projekte të ardhshme me interes të përbashkët, me qëllim uljen e përgjithshme të konsumit të energjisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit energjetik në Kosovë.



PËRBALLË NJË AKUZE PA PROVA

Përkitazi librit „Drejtësia pa llogaridhënie” të Ibish Nezirit, botim i ShB-së „Armagedoni”, Prishtinë, 2026

(Shprehjen „pa llogaridhënie” nuk duhet kuptuar ad literam)



Bedri ZYBERAJ

Hyrje

Të nderuar të pranishëm,

Libri që po promovojmë sot, këtu në Shkup, „Drejtësia pa llogaridhënie” i autorit Ibish Neziri, botuar në dy gjuhë: shqip – anglisht, për aq sa di unë është libri i dytë, pas atij të Akademik Arsim Bajramit „Gjykata Speciale – Midis të vërtetës dhe mashtrimeve” (Prishtinë, 2025) që merren me problemin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.

Në fakt, më herët, më 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, patën botuar në një vëllim të përbashkët punimet e Sesionit shkencor të mbajtur më 7 mars 2022 në Prishtinë me temën bosht „UÇK-ja vlerë kombëtare”.

Në atë libër qenë përfshirë punimet shkencore të pjesëmarrësve të 8 institucioneve shkencore dhe kulturore mbarëshqiptare në krye me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Shqipërisë, të cilat, në nëntor të vitit 2020, pak më shumë se dy javë pas arrestimit të drejtuesve më të lartë të UÇK-së patën dalë me një deklaratë të përbashkët, si reagim ndaj fillimit të fushatës së arrestimeve të pjesëtarëve të UÇK-së dhe drejtuesve të saj nga këto dhoma.

Reagimi i atëhershëm i drejtuesve të këtyre 8 institucioneve, njëri prej tyre ishte edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve – Shkup, tek i cili po e bëjmë sot këtë promovim, ishte rrjedhojë e një dyshimi të bazuar për një fillim të keq të punës së këtyre dhomave, ngase nuk na pëlqente qasja selektive e cila ishte normëzuar me Ligjin për Dhomat e Specializuara.

Atëbotë, reagimi i atyre tetë institucioneve^[1], sado që ishte në fillim të punës së DSK-së,

u kalua disi në heshtje, ndërkaq Dhomat e Specializuara vazhduan me aktivitetin e tyre, pa asnjë lloj mbikëqyrjeje dhe kontrolli nga institucione vendore të Kosovës, apo ndonjë mekanizëm i pavarur ndërkombëtar.

Mungesa e kësaj mbikëqyrjeje, si duket i ka dhënë liri të pakufizuar stafit të këtyre dhomave, që të veprojnë si të duan me arbitraritet të pakufizuar, pa përfillur, jo vetëm legjislacionin e shtetit të Kosovës, Kuvendi i të cilit i ka themeluar ato, por as standardet dhe Konventat ndërkombëtare që rregullojnë problemin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

të panjohurës, por nga faktet që ka prodhuar praktika dhe vendimet e këtyre Dhomave. Pra, analizat e këtyre autorëve nuk janë të bazuara në intuitë dhe frikë për rrezikun e një deformimi, por mbi veprime faktike të cilat u mundësojnë atyre të konstatojnë shkeljet e panumërta që këto dhoma kanë bërë dhe po bëjnë edhe sot e kësaj dite.

Derisa libri i parë „UÇK – vlerë kombëtare” ishte një lloj reagimi më tepër mbi bazën e një intuitede, dy librat e fundit, „Gjykata Speciale” e Arsim Bajramit dhe „Drejtësia pa llogaridhënie” janë produkt të vëzhgimit dhe analizës së një praktike të deformuar në

Specializuara të Kosovës në Hagë, nuk ndalon vetëm në mungesën e llogaridhënies së këtyre Dhomave, siç na shfaqet që në titull që tanimë duket qartë se ka rezultuar me deformim të drejtësisë, por shkon përtej saj, duke shtruar disa pyetje që domosdoshmërisht duan përgjigje.

Por, para se të kalojmë te këto pyetje le të shohim se cilat janë premiset e këtij libri sipas vet autorit.

Që në fillim, Neziri e informon lexuesin se „Një nga premiset themelore të këtij libri është se Dhomat e Specializuara nuk janë produkt i një nevoje juridike autonome, por rezultat

përfshirë krime masive ndaj civilëve shqiptarë, nuk janë objekt i juridiksionit të tyre”^[4]. Kjo gjë paraqet një anomali të llojit të vetë për praktikën e drejtësisë, jo vetëm kosovare, por dhe përtej saj.

Për këtë arsye, sipas asaj që shpaloset në këtë libër, shohim se sot jemi para një fakti, ku në emër të drejtësisë, si në asnjë rast tjetër, janë bërë shkelje të të drejtave të të akuzuarve për të qenë palë të barabarta me organin e akuzës: Janë bërë shkelje me paraburgimin e tejzgjatur; janë bërë shkelje në të drejtën e shfrytëzimit të lejeve të natyrës humane (moslejimi i vizitave të të akuzuarve në raste sëmundjesh apo vdekjesh të anëtarëve të familjes së ngushtë); janë bërë shkelje të të drejtave të identifikimit dhe dinjitetit kombëtar (J. Krasniqit i hiqet kravata për shkak të ngjyrave kuq e zi, ndërsa më 28 Nëntor 2025, mbahet seancë gjyqësore e procesit të dytë kundër Hashimm Thaçit); janë bërë shkelje të identifikimit shtetëror. Këto Dhoma, nuk kanë asnjë shenjë dalluese të shtetësisë së Kosovës – shtetit, organi legjislativ i të cilit i ka themeluar. Bile, edhe vizitën e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, këto dhoma ia lejojnë me kufizime të shumta, kundrejt të cilave, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Naim Qelaj, më 20 nëntor 2025 ka lëshuar një



Nga fusha akademike, atë heshtje e theu prof. dr. Arsim Bajrami me librin „Gjykata Speciale – Midis të vërtetës dhe mashtrimeve”, dhe tani pas tij është dhe Ibish Neziri me librin për të cilin jemi tubuar sot këtu.

Këta dy libra, „Gjykata Speciale” e Arsim Bajramit dhe „Drejtësia pa llogaridhënie”, ndryshe nga ai botimi i veçantë „UÇK – vlerë kombëtare” i vitit 2022, janë produkt të vëzhgimit dhe analizës së një praktike të deformuar në aspektin juridik, e cila, pa dyshim që në analet e historisë së praktikave gjyqësore do të trajtohet si një precedent i veçantë.

Në fund, është një biografi e shkurtër për autorin e tij, Ibish Nezirin. Në librin „Drejtësia pa llogaridhënie”, autori, duke iu referuar praktikës së deritanishme të Dhomave të

aspektin juridik, e cila, pa dyshim që në analet e historisë së praktikës gjyqësore do të trajtohet si një precedent i veçantë.

Pyetje që duan përgjigje

Libri „Drejtësia pa llogaridhënie” hapet me një parathënie të shkurtër nga autori i kësaj reçence dhe vazhdon me 19 pjesë të një tërësie të analizës së problemit të formimit dhe funksionimit të Dhomave të Specializuara si dhe anomalive që janë shfaqur nga ana e tyre në proceset e deritanishme.

Në fund, është një biografi e shkurtër për autorin e tij, Ibish Nezirin.

Në librin „Drejtësia pa llogaridhënie”, autori, duke iu referuar praktikës së deritanishme të Dhomave të

i një procesi politik dhe institucional që buron drejtpërdrejt nga Raporti i Dick Martyt dhe nga mënyra se si ai raport u instrumentalizua në arenën ndërkombëtarë^[2], për të vazhduar me konstatimin se „Kjo gjykatë nuk u ngrit si përgjigje ndaj një boshllëku universal të drejtësisë, por si mekanizëm i jashtëzakonshëm, me juridiksion të kufizuar në mënyrë selektive dhe me një mandat që në praktikë ka prodhuar një drejtësi asimetrike”^[3].

Në thelb të kësaj drejtësie asimetrike, sipas autorit „qëndron një fakt i pakontestueshëm: Dhomat e Specializuara merren ekskluzivisht me krime të supozuara të shqiptarëve, ndërkohë që krimet e kryera nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në Kosovë,

Komunikatë për shtyp^[5]. Për autorin e këtij libri, këto shkelje nuk janë devijim i një rrugëtimi, por produkt i një fillimi të dyshimtë ndaj çështjes së Kosovës së çliruar, i cili pikën e vet kulminante e ka arritur me formalizimin institucional të Raportit të Dik Martit me Rezolutën e KE-së, më 2011.

Sipas Ibish Nezirit, as këtu nuk është fillimi. Përmes pyetjeve që shtron ai në libër për disa çështje, historia e kësaj nisme shkon dhe përtej kësaj kohe, por që vet autori nuk merr mundin t’u japë përgjigje, pasi që konsideron se përgjigjet në ato pyetje duhet t’i japin institucionet e specializuara të hetuesisë dhe të drejtësisë. Pyetjet që shtron autori, për fat të keq, deri tani, nuk janë bërë, as nga institucionet kompetente, por as edhe nga njerëz të publicistikës dhe të historisë. Dhe pasi që nuk janë bërë s’ka pasur si të merren

përgjigjet.

Në këtë mënyrë, për mendimin tim, Ibish Neziri prek thelbin e çështjes së mënyrës së formimit të këtyre dhomave. Ato janë formuar si rrjedhojë e një deformimi të së vërtetës dhe, për fat të keq, sipas autorit, në mungesë të llogaridhënies, vazhdojnë të jenë në funksion të deformimit të drejtësisë dhe të historisë së një lufte që e kemi përjetuar, shumica prej nesh në këtë sallë, gjatë viteve 1997-1999.

Pas miratimit të Rezolutës së Këshilli të Evropës në bazë të Raportit Marti, në janar të vitit 2011, Kosovës i është imponuar formimi i entiteteve juridike: Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar e Kosovës, për të cilat, institucionet e Kosovës, në fillim nuk është se nuk kishin rezerva, por nuk e patën kundërshtuar dhe penguar formimin e tyre, ngaqë pretendimet e atij raporti (Raportit Marti) ishin aq të pakuptimta sa që askush nuk ka menduar që një njeri normal mund ta besonte një gjë të tillë, e le më ta provonte me ndonjë të dhënë si diçka të vërtetë. Pretendimet për trafikim organesh nga një guerile që ushtarët i vdisnin për një infuzion, dhe të kryera në një vend ku energjia elektrike ishte diçka e dëshirueshme për të paktën gjysmën e ditës prej 24 orësh, ishte gjëja më absurde që mund të mendojë njeriu. Megjithatë, ky Raport u formalizua dhe u institucionizua nga KE, pas të cilit fillimisht u bënë hetime nga një Task Force që konstatoi se nuk kishte trafikim organesh.

Dhe pyetja që shtron autori, se pse me aq ngulm u pretendua për të bërë hetime dhe u hetua për trafikim organesh atje ku nuk kishte kushte për gjëra të tilla dhe, mbi të gjitha, **nuk kishte as kufoma**, ndërkaq u hesht për 744 kufomat që janë gjetur në Batajnicë – vetëm 20 km larg VMA-së (Vojna Medicinska Akademia)



Akademisë Mjekësore Ushtarake, ku rreth tri dekada më herët kishte filluar transplantimi i organeve?, ngrë një dyshim të bazuar për një qëllim jo të mirë ndaj Kosovës dhe lirisë së saj.

Kjo mënyrë e shtruarjes së kësaj pyetje, pa çka se ka dhe diçka retorike brenda vetes, për lexuesin paraqet një enigmë më vete, së cilës, derisa nuk i jepet përgjigje e plotë nga organe kompetente, do të jetë në funksion të heshtjes së të vërtetës së asaj kohe dhe të prodhimit të deformimeve në fushën e drejtësisë, edhe në të ardhmen, si deri tani.

Dhe përgjigjen, autori, as nuk përpigjet ta japë vetë, edhe pse siç thash më parë ka diçka retorike në pyetjen që e shtron, por as nuk e kërkon një gjë të tillë nga akëcili njeri, por nga institucione të specializuara dhe kompetente për këtë çështje.

Për mendimin tim kjo është pjesa më e vlershme e librit, sepse shtron kërkesën për një rikthim të hetimeve më cilësore dhe më të plota, sidomos për ato kufoma që janë gjetur në

Batajnicë. Pra, rikthim i hetimeve për trafikim të organeve atje ku janë gjetur kufoma, ku për të ardhur deri te e vërteta duhet të konstatohet se si u dërguan ata njerëz deri atje? Të gjallë apo të vdekur? Cili ka qenë shkaku i vdekjes së tyre? E jo hetimet të kufizohen vetëm në identifikimin e tyre, siç kanë vepruar mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë menjëherë pas luftës, duke u mjaftuar me atë identifikim por pa e hetuar edhe mënyrën e vrasjeve.

Mungesa e një hetimi të tillë, ka krijuar një vakum që Serbia e ka shfrytëzuar për ta mbushur me akuzën për trafikim organesh nga UÇK-ja dhe t'ia katapultojë atë atë akuzë, përmes një Senatori fodull, faktorëve relevantë evro-amerikanë dhe t'i fusë ata në lajthitje për të bërë hetime atje ku nuk kishte as kufoma dhe as kushte, por ta fshehë VMA-në, faktin, ku kishte një traditë prej dekadash për transplantim organesh dhe kishte 744 kufoma shqiptarësh. Ibish Neziri, me të drejtë ngrë dyshimin në formë teze që nxjerrja e organeve mund të

jetë bërë nga vetë Serbia. Por, kjo e fundit shfrytëzon vakumin e mungesës së hetimeve të duhura dhe këtë pretendim makabër, ia atribuon UÇK-së. Një fenomen i tillë është i njohur për psikologjinë dhe quhet „Projeksion i vetvetes”, që nënkupton një shtrembërim të së vërtetës, kur, njëra palë ai atribuon tjetrës ndjenjat, mendimet, tipare që i ka vetë dhe veprimet që i ka bërë ose mund t'i bëjë vetë. Pikërisht këtë hamendësim shtron Ibish Neziri, kur bën fjalë për akuzën për trafikim organesh nga UÇK-ja.

Një gjë të tillë Serbia e ka praktikuar edhe më parë. Le të kujtojmë këtu akuzën e kohës së Luftës, kur për rastin „Panda” në Pejë e pat akuzuar UÇK-në se ka vrarë gjashtë të rinj serbë, por që më vonë, prej vetë zyrtarëve të lartë të këtij vendi përfshi edhe kryetarin Alksandër Vuçiqi i cili ka pohuar se i dinë vrasësit, por kurrë nuk janë bërë publikë emrat e tyre dhe nuk është ndërmarr ndonjë veprim nga drejtësia e këtij shteti për të

hetuar dhe dënuar kryerit e atij veprimi kriminal.

Tani, familjarët e të vrarëve të 14 dhjetorit 1998 në Pejë, po kërkojnë që Prokuroria ta intervistojë Aleksandër Vuçiqin në lidhje me këtë akt terrorist,^[6] për të cilin, kohë më parë, „ish-prokurori i Serbisë për krimet e luftës, Vladimir Vukçević, për BIRN-in kishte deklaruar se pas hetimeve “Ne arritëm në përfundimin se shqiptarët nuk janë autorët e krimet,”^[7], sepse ishte fakt i njohur që në rajonin e Pejës, në kohën e sulmit në “Panda Café”, nuk kishte “pothuajse asnjë shqiptar”.^[8] Neve natyrshëm na imponohet pyetja: Nëse shqiptarët nuk paskëshin qenë autorët e krimet, siç keni akuzuar në krye të herës dhe më shumë se një dekadë më vonë duke e akuzuar UÇK-në, atëherë kush ishin vrasësit e tyre, për të cilët Aleksandër Vuçiqi deklaroi se „i dinë emrat”?!
Neziri ngrë dyshim. Të vërtetën e kërkon që ta zbulojnë organet kompetente.

Siç e dimë, Kosovës iu kërkuua me imponim që t'i formonte Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar dhe ajo e bëri këtë gjë me amendamentim të Kushtetutës dhe me Ligjin e veçantë të miratuar në gusht të vitit 2015. Këto dhoma, sipas autorit të këtij libri, tani janë shndërruar në një teatër absurd, në skenën e të cilit po luhen pjesë tragjikomike që, nëse vazhdohet kështu edhe me drejtuesit e UÇK-së, siç është vepruar me Pjetër Shalën, me Salih Mustafën – Calin, po pse jo edhe me Nasim Haradinajn e Hysni Gucatin, verdikti i tyre do të rezultojë me pasoja jo vetëm për ato katër personalitetet që kanë qenë dhe janë subjekte të hetimit dhe gjykimit, por pasojat më të mëdha do t'i kenë, e kaluara historike prej së cilës ka rezultuar shtetësia e Kosovës dhe sidomos e ardhmja, jo vetëm e saj, por e tërë kombit shqiptar dhe përtej tij.



Një çështje tjetër, dëshmitarë të të cilës jemi secili prej nesh, që ka tërhequr vëmendjen e autorit është dhe koha e gjatë e paraburgimit për katër ish-drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: z. Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi që, sipas autorit, bie ndesh me standardin e përcaktuar nga GjEDNj. GjEDNj në lidhje me paraburgimin saktëson se „*dyshimi i arsyeshëm*” mund ta justifikojë paraburgimin vetëm në fazat fillestare të procedurës, por me kalimin e kohës ai humbet forcën e tij legjitimuese. Në këtë kuptim, kalimi i kohës punon në favor të lirisë, jo kundër saj.^[9]

Në rastin e gjyqimit të krerëve të UÇK-së nga Gjykata e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, jo vetëm që nuk zbatohet ky standard, por, sikur të mos

që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Këto janë disa nga çështjet dhe shqetësimet thelbësore që ngre autori në këtë libër e të cilat, për mendimin tim paraqesin një kontribut të veçantë për të këtij autori për ndriçimin e së vërtetës për luftën e UÇK-së, për tendencën e e rrezikshme për shtrembërimin e kësaj të vërtete dhe sidomos për shkarjen e drejtësisë në kthetrat e kësaj tendence.

Përfundim

Ibish Neziri është njeri që moshën e jetës së vet e ka të ndarë në dy pjesë. Gjysmën e parë të saj e ka jetuar në një sistem monist (në ish-Jugosllavi), ku ka qenë edhe i burgosur e i përndjekur, ndërkaq gjysmën tjetër në Evropën Perëndimore (në

relativizuar krimet, por për të analizuar një proces që, me kalimin e kohës, ka nxjerrë në pah mospërputhje serioze ndërmjet parimeve të shpallura të drejtësisë ndërkombëtare dhe praktikës së saj konkrete ndaj Kosovës.”^[11] dhe „jo për të mohuar krime lufte, por për të mos pranuar pa prova një akuzë që kërkonte standardin më të lartë të verifikimit”.^[12]

Bedri Zyberaj
Prishtinë, janar-shkurt 2026
Fjalë rasti në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 25 shkurt 2026, në përfundimin e librit “Drejtësia pa llogaridhënie” të Ibish Nezirit.

^[1] Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë, Insitituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, Insituti i Trashëgimisë Kulturore dhe



ishte e mjaftueshme masa e paraburgimit, sa vijnë e shtrëngohen kufizimet tjera. Ish-Presidentit Thaçi, trupi gjykues ia ndalon edhe kontaktet me vëllezërit, gjë që, sipas autorit të librit, nuk mund të interpretohet ndryshe veçse si mohim i të drejtave themelore, shkelje e dinjitetit njerëzor dhe tentativë për izolim total të një të pandehuri.

Përtej këtyre masave vjen në radhë vetëm ajo e ndalimit të ushqimit.^[10] shprehet në formë konkludimi për këtë rast, Ibish Neziri, me një dozë zemërim të përmabajtur.

Përveç këtyre, lexuesi, në këtë libër do të gjejë edhe disa pyetje të tjera që shtrihen autori në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë e të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Mungesa e përgjigjeve të tyre dhe sidomos mungesa e një mbikëqyrjeje të Dhomave të Specializuara, janë parakushtet themelore që kanë mundësuar promovimin e një drejtësie pa llogaridhënie, gjë që paraqet shkelje jo vetëm të normave kushtetuese dhe ligjore vendore (të Kosovës), por edhe të standardeve ndërkombëtare

Zvicër), në një hapësirë ku liritë dhe të drejtat e njeriut kanë qenë dhe janë të shenjta.

Meqenëse në pjesën e dytë të jetës së tij ka, për së afërmi e ka prekur dhe e ka provuar shijen e demokracisë dhe të lirisë së Evropës Perëndimore, dhe për faktin e të qenit gazetar dhe redaktor (në pjesën më të madhe të kohës) i disa medieve të shkuara dhe audiovizuale perëndimore dhe properëndimore (medieve kroate „Hrvatska Danas” e „Hrvatska Domovina”, „RTV ABC” – radiotelevizion austriak, revistës mujore zvicerane „Arbeitsmarkt Agenda” – Cyrih, Radios „Zëri i Kosovës” Kopenhagë” etj.), nuk ka mundur të rrijë duarkryq përballë një padrejtësie që po i bëhet një vlere historike të shqiptarëve, por edhe përballë një rreziku që është shndërruar në precedent për drejtësinë në përgjithësi.

Libri „Drejtësia pa llogaridhënie” është një reagim racional i autorit, i cili është konceptuar, mbarështuar dhe botuar, siç e thotë vetë ai, „Jo për të mbrojtur individë dhe as për t’i

Shpirtërore – Shkup, Muzeu Kombëtar i Shqipërisë, Institutit i Historisë „Ali Hadri”, Muzeu Kombëtar i Kosovës dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

Kanë qenë të ftuar që t’i bashkohen atij reagimi dhe ta nënshkruanin atë deklaratë edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Biblioteka Kombëtare e Kosovës „Pjetër Bogdani”, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Qendra e Studimeve Albanologjike – Tiranë, por drejtuesit e këtyre institucioneve, në atë kohë, patën refuzuar.

^[2] Ibish Neziri, *Drejtësia pa llogaridhënie*, ShB „Armagedoni” Prishtinë 2026, fq. 12

^[3] Po aty, Fq. 12

^[4] Po aty. Fq. 12

^[5] <https://oik-rks.org/2025/11/20/komunikat-e-per-shtyp-ne-lidhje-me-viziten-e-tij-te-fundit-te-dhomat-e-specializuara-te-kosoves-ne-hage/>

^[6] <https://telegrafi.com/babai-kerkon-qe-vuciq-te->



[intervistohet-ne-lidhje-me-vrasjen-e-te-birit-cfare-ndodhi-ne-kafenene-panda/](https://thegeopost.com/lajme/serbia-dhe-rasti-panda-kur-propaganda-serbe-vret-edhe-te-rinjte-e-vet/)

[7](https://thegeopost.com/lajme/serbia-dhe-rasti-panda-kur-propaganda-serbe-vret-edhe-te-rinjte-e-vet/)

[8](https://thegeopost.com/lajme/serbia-dhe-rasti-panda-kur-propaganda-serbe-vret-edhe-te-rinjte-e-vet/)


[/serbia-dhe-rasti-panda-kur-propaganda-serbe-vret-edhe-te-rinjte-e-vet/](https://thegeopost.com/lajme/serbia-dhe-rasti-panda-kur-propaganda-serbe-vret-edhe-te-rinjte-e-vet/)

^[9] Ibish Neziri, *Drejtësia pa llogaridhënie*, ShB „Armagedoni” Prishtinë 2026, fq. 23

^[10] Po aty fq. 67

^[11] Po aty fq. 16

^[12] Po aty fq. 35



ShTFRK-ja dhe FFK-ja organizojnë seminar për stafet mjekësore të klubeve të futbollit



PRISHTINË, 2 MARS - Shoqata e Trajnerëve e Futbollit e Republikës së Kosovës (ShTFRK), në bashkëpunim me Federatën e Futbollit e Kosovës (FFK), do ta organizojë seminarin njëditor me stafet mjekësore të

angazhuara në klubet e futbollit. Ky seminar ka për qëllim avancimin e njohurive profesionale dhe shkëmbimin e praktikave të fundit në fushën e mjekësisë sportive. Ligjërues i seminarit do të jetë

prof. ass. dr. Rilind Obërtinca, i cili do të trajtojë në mënyrë të hollësishme aspektet më të rëndësishme që lidhen me parandalimin e lëndimeve në futboll. Seminari do të mbahet më 6 mars, me fillim në orën 9:30, në sallën e

konferencave në selinë e FFK-së. Pjesëmarrja në këtë seminar paraqet mundësinë e vlefshme për përmirësimin e praktikës profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të stafit mjekësor dhe klubeve.

SHKRUHET HISTORIA: PILOTJA E KOSOVËS RENDITET E PARA NË BOTË NË PARAGLLAJD

PRISHTINË, MARS - Sporti ajror i Kosovës ka shënuar një çast historik. Pilotja e paragllajdit, Lisjeta Thaqi, është renditur e para në botë në kategorinë e femrave, duke e vendosur Kosovën në krye të paragllajdit të precizionit në arenën ndërkombëtare. "Ky sukses i jashtëzakonshëm përfaqëson më shumë se një arritje personale. Ai është një fitore

për sportin kosovar, për komunitetin e aviacionit sportiv dhe për të gjithë ata që besojnë në punën e palodhur, disiplinën dhe vizionin afatgjatë. Arritja vjen nën udhëheqjen e trajnerit të saj, rekordmenit botëror dhe evropian, Fanol Shala, i cili me përkushtim dhe përvojë ka ndërtuar një ekip kampionësh që sot po shkruajnë histori në

skenën botërore", ka njoftuar Federata Aeronautike e Kosovës. Nën ombrellën e Federatës Aeronautike të Kosovës, ky rezultat dëshmon se Kosova tashmë është një forcë serioze dhe konkurruese në paragllajdin e precizionit, duke u përballur me sukses me vendet më të fuqishme të këtij sporti.



MË 22 MARS MBAHET EDICIONI I PESTË I GARËS TRADICIONALE "VRAPIMI I MARSIT - IZBICA 147"

PRISHTINË, 2 MARS - Më 22 mars 2026 do të organizohet edicioni i pestë i garës tradicionale përkujtimore "Vrapimi i Marsit - Izbica 147", aktivitet që mbahet në nderim të martirëve të masakrës së Izbicës dhe dëshmorëve të komunës së Skenderaj. Kjo garë sportive tashmë është shndërruar në një aktivitet të rëndësishëm



përkujtimor dhe sportiv, që bashkon vrapues nga mbarë Kosova, trojet shqiptare dhe diaspora. Organizatorët kanë bërë me dije se gara do të zhvillohet në dy disiplina: 10 kilometra dhe 21 kilometra, duke krijuar hapësirë pjesëmarrjeje si për vrapues elitare, ashtu edhe për ata fillestarë që duan të bëhen pjesë e këtij organizimi

simbolik. Përmes këtij aktiviteti synohet të përkujtohet sakrificat e martirëve të masakrës së Izbicës, të promovohet sporti dhe vrapimi malor, si dhe të forcohet tradita e organizimeve sportive dhe përkujtimore në këtë zonë. "Vrapimi i Marsit - Izbica 147" ka arritur të ndërtojë një identitet të veçantë ndër vite,

duke e lidhur aktivitetin sportiv me kujtesën historike dhe duke krijuar një moment bashkimi për komunitetin dhe sportdashësit. Të interesuarit për pjesëmarrje mund të regjistrohen përmes platformave online të "Vrapimi i Marsit - Izbica 147", ndërsa regjistrimi do të mbetet i hapur deri më 17 mars 2026.

MARIO ILIEVSKI SHPALLET "YLLI I JAVËS" NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 2 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ndarjen e çmimit tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e njëzet e dytë të këtij edicioni ky çmim i është dhënë për herë të dytë futbollistit të FC Prishtina, Mario Ilievski, i cili ka shënuar një eurogol nga distanca më shumë se 40

metra në ndeshjen kundër FC Drita, e cila ka përfunduar me rezultat 1:1. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë këtë çmim, Mario është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. "Fillimisht, faleminderit për vlerësimin! Kam shënuar një gol të çmendur dhe nuk dija as si të veproja, por vetëm kam vrapuar tek fansat që të festojmë bashkë. Është një gol që nuk shënohet çdo herë.

Kemi edhe 14 ndeshje dhe çdo ndeshje është një finale për ne. Nuk jemi të lumtur me rezultatet, sepse e dimë që mund të bëjmë më mirë e më mirë, por do të luftojmë në çdo ndeshje që të dalim në vendin e parë. Dua këtë çmim t'ua dedikoj tifozëve 'Plisat', të cilët na dhuruan një atmosferë të zjarrtë dhe shpresoj që do të jenë në çdo ndeshje për të na dhuruan një atmosferë të tillë", ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.



OBAVEŠTAVAMO

Našeg suvlasnika sa suvlasničkim idealnom deom : **SADIKI REIMKA 1/14** , kao zainteresovanog kupca da mi kao suvlasnici na parceli : **P-71813063-00289-3 ZK Petrovo Selo Opština Prizren** sa suvlasničkim idealnim delovima : **Sadiki Asim 1/8 , Sadiki Safeta 1/14 , Redza Fatime 1/14 , Sadiki Veljija 1/8 , Sadiki Atima 1/8 , Sadiki Jasmina 1/4 , Sadiki Xhelil 1/14 , Sadiki Ramadan 1/8 , Krasniqi Mida 1/14** prodajemo u celosti naše suvlasničke delove .

Shodno zakonskim propisima o prodaji nepokretnosti neophodno je da se prodaja ponudi najpre suvlasniku koji ima pravo na preče kupovine pa ako moj suvlasnik ne želi da kupi onda se ta prodaja može izvršiti drugim licima odnosno kupcem .

Ovim putem nudimo suvlasniku ukoliko je zainteresovan za kupovini da se javi u roku od **30 dana** platiti sveukupnu cenu **kupoprodajnu cenu od 225.000 €** I to načinom uplate u gotovini / odjednom .

Kontakt Telefon : **045473300**

Prizren : 03-03-2026 .

OBAVEŠTAVAMO

Našeg suvlasnika sa suvlasničkim idealnom deom : **SADIKI ASIMA 1/14** , kao zainteresovanog kupca da mi kao suvlasnici na parceli : **P-71813063-00289-3 ZK Petrovo Selo Opština Prizren** sa suvlasničkim idealnim delovima : **Sadiki Asim 1/8 , Sadiki Safeta 1/14 , Redza Fatime 1/14 , Sadiki Veljija 1/8 , Sadiki Atima 1/8 , Sadiki Jasmina 1/4 , Sadiki Xhelil 1/14 , Sadiki Ramadan 1/8 , Krasniqi Mida 1/14** prodajemo u celosti naše suvlasničke delove .

Shodno zakonskim propisima o prodaji nepokretnosti neophodno je da se prodaja ponudi najpre suvlasniku koji ima pravo na preče kupovine pa ako moj suvlasnik ne želi da kupi onda se ta prodaja može izvršiti drugim licima odnosno kupcem .

Ovim putem nudimo suvlasniku ukoliko je zainteresovan za kupovini da se javi u roku od **30 dana** platiti sveukupnu cenu **kupoprodajnu cenu od 225.000 €** I to načinom uplate u gotovini / odjednom .

Kontakt Telefon : **045473300**

Prizren : 03-03-2026 .



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Niki Rec" Sh.p.k. kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/9051/MMPHI/787/DMM,për veprimtarinë: Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike sipas kodeve: 02 01 10, 16 01 06, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, Rashincë, Shtime, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 25.02.2026, në ora: 11:00, në hapësirat e Restorant Lisi në Shtime, do të organizohet debat publik nga operatori "Niki Rec" Sh.p.k. kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore, sipas kopjes fizike me Nr.Prot. 25/9051/MMPHI/787/DMM, për veprimtarinë: Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike sipas kodeve: 02 01 10, 16 01 06, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, Rashincë, Shtime, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxa dVorQT09>

Linku i Komunës së Shtimes:

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Linku i gazetës ditore:

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmpHI.rks-gov.net/Document?search=nIKI>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"Niki Rec" shpk



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agnesa Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-5 të shkollës "Xhavit Ahmeti" Prishtinë.

- Guri Çeku shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-5 të shkollës "Iliria" Prishtinë.

- "EMC Company" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 812097617.

- "Flawless" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues: 811508615.

- Diamant Hameli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ibrahim Fehmiu" në Prizren.

- Ideal Sallauka shpall te pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gjon Buzuku" Prizren.

- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë të gjimnazi "Frang Bardhi".

- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507.

- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë "Dr, Xheladin Deda".

- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" ish shkolla fillore "Emin Duraku" Likoc Skenderaj.

- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta" Prekaz i Eperm Skenderaj.

- Rustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Trepça" Stanterg.

- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Malush Ahmeti" ish shkolla "Muharrem Bekteshi" Rezalle Skenderaj.

- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës "Gjin Gazulli" Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale "Dituria" Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Kuvendi i Juniku" Junik.

Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Xhelal Hajda Toni" Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

